

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6388
E hënë, 16 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Rritet numri i pacientëve me Covid që po trajtohen në spitalet e Kosovës | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



INSTITUCIONET E KOSOVËS I JANË PËRGJIGJUR POZITIVISHT KËRKESËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) PËR POPULLATËN AFGANE | FAQE 4-5

KOSOVA E GATSHME T'I STREHOJË AFGANËT



Republika e Kosovës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për strehim të përkohshëm të afganëve të cilët tani janë në shënjestër të talebanëve.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pa asnjë hezitim apo kushtëzim ka dhënë pëlqimin e saj për një operacion të tillë humanitar. Edhe subjektet opozitare në vend janë shprehur

për strehimin e afganëve në Kosovë. Sipas tyre, askush më mirë se qytetarët e Kosovës nuk e dinë se çfarë do të thotë të dëbohesh e të largohesh me dhunë nga vendi ku je rritur

AKTUALE

ZGJEDHJET LOKALE, 29 SUBJEKTE POLITIKE APLIKUAN NË KOZ | F. 4

HAZIRI: GJILANI REALIZOI TË HYRA PËR 217 PËR QIND MË SHUMË SE NË VITIN 2020 | F. 3

ALI NIMANAJ, KANDIDAT I PDK-SË PËR KRYETAR TË ISTOgut | F. 7

EKONOMI



BAJRAMI, KURTIT: ASNJË VENDIM NUK E KENI MARRË PËR TA NDIHMUAR EKONOMINË | F. 8

RUKIQI: RIMËKËMBJA EKONOMIKE, E VARUR NGA VAKSINIMI | F. 8

KULTURË



NANA ME 4 DJEM, NË BURGUN E HAGËS?! | F. 12

Shkruan: Riza GREIÇEVCI

FLET PËR "EPOKËN E RE" PULMOLOGU BESIM MORINA

Punëtorët shëndetësorë, të arsimit dhe të administratës është dashur të kushtëzohen me vaksinim | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pritje të gjata në pikat kufitare

PRISHTINË, 15 GUSHT - Qytetarët e Kosovës, të cilët jetojnë në vende të ndryshme perëndimore, gjatë udhëtimit të tyre për në Kosovë dhe kthimit për në vendet ku

jetojnë, po ballafaqohen me pritje të gjata në pikat kufitare. Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar në Kosovë njofton se pritjet në disa pikëkalime kufitare,

sidomos në dalje, po zgjasin. Të dielën është raportuar nga dy deri në shtatë orë pritje. Pritjet më të gjata janë në pikën kufitare në Merdar, Dheu i

Bardhë, Mutivodë dhe Jarinjë. Pritjet e gjata të qytetarëve të Kosovës në pikat kufitare ndodhin çdo vit gjatë sezonit të verës.



Suspendohen katër pjesëtarë të Policisë së Kosovës



PRISHTINË, 15 GUSHT - Katër policë të Kosovës, me detyrë në stacionin policor në Mitrovicë të Veriut, janë suspenduar nga puna. Policët e suspenduar me vendim të drejtorit të policisë dyshohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Suspendimi i zyrtarëve policorë, sipas Policisë së Kosovës, vjen si rezultat i pamjeve të publikuara në disa portale dhe rrjete sociale, të cilat tregojnë pamjet

se si zyrtarë policorë në uniformë, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, kalojnë kohën në një lokal/sport-klub. Veç suspendimit të përkohshëm, stacioni policor Mitrovicë Veri ka iniciuar procedurën për hetim të shkeljeve të supozuara, ndërsa "procedurat e tjera të hetimeve të brendshme disiplinore do të udhëhiqen nga hetuesit policorë të Drejtorisë së

Standardeve Profesionale". "Vetëdisiplina dhe disiplina organizative janë elementet bazë mbi të cilën ndërtohen vlerat e Policisë së Kosovës, në shërbim të qytetarëve dhe zbatimit të ligjit, prandaj veprimet e tilla, shkeljet e tilla disiplinore nuk do të tolerohen dhe, si të tilla, do të jenë të ndëshkueshme", thuhet në një njoftim për media të Policisë së Kosovës.

Vazhdojnë kërkimet për të mbijetuarit e tërmetit në Haiti

LES CAYES, 15 GUSHT - Ekipet e shpëtimit po vazhdojnë punën për të gjetur të mbijetuar pas tërmetit të fuqishëm prej 7.2 shkallësh që goditi Haitin dhe la të vdekur të paktën 304 persona. Epiqendra e tërmetit, që shkatërroi ndërtesa të shumta, ishte rreth 160 kilometra nga kryeqyteti Port-au-Prince. Autoritetet thanë se të paktën 1 800 persona janë lënduar pas kolapsimit të shumë ndërtesave. Ekipet e shpëtimit

janë duke vazhduar punën për të gjetur njerëzit që janë bllokuar nën rrënoja. Mbrojtja civile ka njoftuar se spitalet tashmë janë mbushur me persona të lënduar nga tërmeti. Shtetet e Bashkuara kanë ofruar ndihmë për Haitin dhe presidenti Joe Biden ka miratuar ndihmën e menjëhershme, ndërsa Republika Dominikane ka dërguar 10 000 racione ushqimore dhe pajisje mjekësore.

Ndërkaq një brigadë me doktorë nga Kuba ka arritur në Haiti për të ndihmuar doktorët atje. Edhe Ekuadori, Meksika, Kili, Argjentina, Venezuela, Spanja kanë ofruar ndihmë për Haitin. Haiti ende nuk është rikuperuar nga një tërmet prej 7 ballësh që goditi vendin më 2010 dhe la të vdekur mbi 200 000 persona. Nga tërmeti i vitit 2010, 1.5 milion banorë të Haitit kishin mbetur të pastrehë.



Spitalet në ShBA, të stërngarkuara me pacientë me Covid



WASHINGTON, 15 GUSHT - Spitalet në disa shtete amerikane janë duke arritur kapacitetet e plota për të trajtuar rastet e rënda me koronavirus, teksa Rusia ka raportuar për një rekord të ri të vdekjeve dhe Brazili ka regjistruar pothuajse 1 000 viktima brenda një dite. Guvernatorja në Alabama ka shpallur gjendje të

jashtëzakonshme pasi punëtorët shëndetësorë në këtë shtet thanë se po përballen me një "valë" të rasteve me Covid-19 që po mbingarkon spitalet. Guvernatorja Kay Ivey tha se gjendja e jashtëzakonshme ka për qëllim të lehtësojë punën e punëtorëve shëndetësorë, por shtoi se nuk do të ketë mbyllje të shtetit dhe as masë për

mbajtjen e detyrueshme të maskave. Shumica e shteteve në ShBA, që udhëhiqen nga republikanët, nuk kanë përfillur këshillat e zyrtarëve federalë shëndetësorë të cilët për javë të tëra kanë rekomanduar që njerëzit të mbajnë maska edhe në ambiente të brendshme, nëse jetojnë në një zonë ku virusi po përhapet me shpejtësi.

Rusia përballet me vërshime

MOSKË, 15 GUSHT - Për shkak të shirave, që kanë shkaktuar vërshime në jug të Rusisë, mbi 1 500 persona janë detyruar që të evakohen. Autoritetet në rajonin Krasnodar kanë theksuar se

mbi 1 400 shtëpi janë vërshuar pas stuhive dhe shirave të rrëmbyeshëm që goditën rajonin këtë javë. Rreth 108 000 banorë në 11 vendbanime kanë mbetur pa energji elektrike.

Sipas shërbimeve emergjente, në total 1 531 persona janë evakuuar. Qyteti Anapa në Detin e Zi është vendi më i goditur nga vërshimet. Zyrtarët e emergjencave kanë

paralajmëruar se mot me shi do të ketë edhe në dy ditët e ardhshme. Përgjatë Detit të Zi dhe në jug, në Turqi, ka pasur vërshime. Në Turqi të paktën 44 persona kanë vdekur si pasojë e vërshimeve.



FLET PËR "EPOKËN E RE" PULMOLOGU BESIM MORINA

Punëtorët shëndetësorë, të arsimit dhe të administratës është dashur të kushtëzohen me vaksinim

Pulmologu Besim Morina e ka vlerësuar shumë shqetësues trendin e rritjes së infektiveve me Covid-19. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Morina ka thënë se shpejtësia e infektiveve për një kohë kaq të shkurtër tregon se institucionet duhet të përgatiten për një skenar të rrezikshëm të pandemisë. Morina ka bërë me dije se vaksinimi është mënyra më e lehtë dhe më e sigurt e parandalimit të sëmundjes, hospitalizimit dhe vdekjes nga Covid-i. Ai ka theksuar se puna e punëtorëve në shëndetësi, arsim dhe në administratë është dashur të kushtëzohet me vaksinim

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Morina, ditët e fundit është rritur numri i infektiveve me Covid-19. Si e keni parë rritjen e këtyre rasteve?

Morina: Edhe pse ka qenë e pritur një valë e re pas paraqitjes së variantit të ri 'Delta' dhe numrit të ulët të të vaksinuarve në vendin tonë, numrat e të infektuarve në ditët e fundit dhe trendi i frikshëm në rritje janë tepër shqetësues. Ne ende nuk e dimë se kur do të ndalet ky trend, kur do ta mbërrijë kulmin e vet kjo valë por, nisur nga shpejtësia e infektiveve për një kohë kaq të shkurtër, duhet të përgatitemi për një skenar të rrezikshëm.

"Epoka e re": Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se pjesa dërrmuese e rasteve të fundit janë me variantin 'Delta'. Çka dihet deri më tani për këtë variant?

Morina: Është shumë më infektues dhe më i rrezikshëm

se varianti paraprak. Ky virus ka treguar që ka një aftësi për të ndryshuar dhe për të zhvilluar forma shumë më agresive. Ky është edhe shqetësimi i shkencëtarëve në botë, që mund të kemi edhe variante shumë më agresive që potencialisht të jenë rezistente ndaj vaksinave aktuale. Për fatin tonë të mirë, vaksinat 'AstraZeneca' dhe 'Pfizer' janë efektive në masën më të madhe ndaj variantit 'Delta'.

"Epoka e re": Ju për çdo ditë përballemi me njerëz që shtrihen në spital nga ky virus. Cila shtresë e qytetarëve tani po preket më shumë nga virusi?

Morina: Të moshuarit, ata me sëmundje kronike, ata me mbipeshë etj., mbeten më të rrezikuarit, të cilët pas infeksionit mund të zhvillojnë sëmundje të rëndë. Megjithatë, për shkak të karakteristikave të variantit të ri si dhe për faktin që një pjesë e madhe e të vaksinuarve janë të moshuar, numri më i madh i të infektuarve janë të moshave të mesme dhe të rinj. Rrjedhimisht vala e fundit është përcjellë me



më shumë pacientë të rinj në moshë të cilët kërkojnë ndihmë mjekësore dhe shtrim në spital.

"Epoka e re": Pavarësisht prej rritjes së rasteve, hezitimi i qytetarëve për t'u vaksinuar po vazhdon. Si duhet të veprojnë institucionet politike dhe shëndetësore për t'i bindur qytetarët për t'u vaksinuar?

Morina: Po të kishim pasur numër më të madh të të vaksinuarve sot do të ishim në një situatë shumë më të mirë epidemiologjike. Ne për disa arsye jemi vonuar në këtë proces. Një ndër to ka qenë një hezitim dhe dyshim i popullatës për marrjen e vaksinës. Institucionet ndoshta është dashur të zhvillojnë fushatë më agresive, përfshirë marrjen e masave më aktive si, për

shembull, kufizimin e aktiviteteve të lëvizjes për të pavaksinuarit, pastaj kushtëzimin e punëtorëve të shëndetësisë, të arsimit e të administratës që për t'u paraqitur në punë paraprakisht të jenë të vaksinuar.

"Epoka e re": Ata që hezitojnë ta marrin vaksinën zakonisht përmendin frikën nga efektet anësore që mund t'i shkaktojë vakcina. Cili është mesazhi juaj për këta njerëz?

Morina: Gjithmonë do të ketë njerëz që kanë dyshime në vaksinë, edhe ndaj vaksinave kundër Covidit. Mirëpo të gjitha studimet kanë treguar që këto vakcina janë të sigurta dhe të padëmshme, me efekte të pakta anësore e komplikime shumë të rralla. Njëkohësisht duhet ta

kemi parasysh që vaksinimi është mënyra më e lehtë dhe më e sigurt e parandalimit të sëmundjes dhe vdekjes nga Covid-19. Me mosvaksinim, përveç që e rrezikojmë veten, mund t'i dëmtojmë të tjerët me të cilët jemi në kontakt.

"Epoka e re": Çfarë ndikimesh mund të ketë vaksinimi për parandalimin e përhapjes së pandemisë?

Morina: E vetmja mënyrë e fitimit të luftës ndaj këtij virusi është vaksinimi i të gjithë njerëzve jo vetëm me këto dy doza, por vaksinimi periodik edhe me doza të tjera përforcuese të imunitetit kundër Covidit. Kështu çdo vit apo periudhë disamujore ne do ta përforconim mbrojtjen kundër virusit.

Haziri: Gjilani realizoi të hyra për 217 për qind më shumë se në vitin 2020

GJILAN, 15 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit ka shënuar rritjen më të madhe ndonjëherë të të hyrave vetjake në kodin e Tatimit në Pronë falë ardhjes masive të mërgimtarëve dhe lojalitetit të tyre për t'i kryer obligimet shtetërore në vendlindjen e tyre.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë analizimit të të hyrave në bazë të shifrave

zyrtare që ka Drejtoria e Financave në Gjilan, ka theksuar se ka rritje të inkasimit në kategorinë e Tatimit në Pronë që, fatbardhësisht, sipas tij, edhe qytetarët e Gjilanit, në masë të jashtëzakonshme u janë përgjigjur pagesave mërgimtarët tanë. "Përkundër që një vit më parë gjilanasit për shkak të pandemisë mbetën pa u takuar me familjarët e tyre në



mërgatë, ata këtë vit kanë ardhur me plot të mira. Në këtë rrafsh përfituese është edhe

komuna e Gjilanit, në kodin buxhetor të Tatimit në Pronë, ku kemi të hyra për 217 për qind më shumë se në gjashtëmujorin e vitit 2020 dhe të hyrat më të mëdha të shënuara ndonjëherë deri më sot kur analizohen edhe dy muajt e sezonit të verës. Deri më tani është realizuar planifikimi në të hyra nga Tatimi në Pronë mbi 74 për qind dhe mbi 63 për

qind nga të hyrat e përgjithshme", ka thënë kryetari Haziri.

Ai ka falënderuar të gjithë mërgimtarët që këtë vit kanë ardhur në vendlindje, duke u dëshiruar atyre pushime të mira në Kosovë dhe njëkohësisht ka uruar fat, shëndet dhe suksese pas kthimit në vendin ku ata janë duke punuar dhe jetuar me familjet e tyre.



INSTITUCIONET E KOSOVËS I JANË PËRGJIGJUR POZITIVISHT KËRKESËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) PËR POPULLATËN AFGANE

Kosova e gatshme t'i strehojë afganët

Republika e Kosovës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për strehim të përkohshëm të afganëve të cilët tani janë në shënjestër të talebanëve. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pa asnjë hezitim apo kushtëzim ka dhënë pëlqimin e saj për një operacion të tillë humanitar. Edhe subjektet opozitare në vend janë shprehur për strehimin e afganëve në Kosovë. Sipas tyre, askush më mirë se qytetarët e Kosovës nuk e dinë se çfarë do të thotë të dëbohesh e të largohesh me dhunë nga vendi ku je rritur

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 GUSHT - Institucionet e Republikës së Kosovës janë shprehur të gatshme t'i strehojnë qytetarët afganë, pas komunikimeve që kanë pasur me autoritetet amerikane. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije të dielën se më 16 korrik është kontaktuar nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett,

i cili ia ka përcjellë kërkesën e presidentit Joe Biden për strehimin e përkohshëm të afganëve. Shefja e shtetit ka treguar se pa asnjë hezitim dhe kushtëzim i ka thënë po kërkesës së amerikaneve. "Kërkesa kishte të bënte me strehimin e përkohshëm të afganëve, civilë të pafajshëm, të cilët tani ishin në shënjestër të talebanëve, vetëm pse kishin qëndruar në anën e aleatëve tanë,

në anën e paqes e demokracisë, në anën e barazisë e të drejtësisë. Ata ishin punëtorë lokalë që kishin punuar bashkë me forcat amerikane si dhe familjet e tyre, përfshirë fëmijë. Pa asnjë hezitim apo kushtëzim të vetëm, kam dhënë pëlqimin tim për një operacion të tillë humanitar", ka shkruar Osmani në profilin e vet në "Facebook", duke treguar edhe arsyet e kësaj përgjigje pozitive. "Duke u nisur së pari nga parimi

njerëzor se nuk u mbyllen dyert atyre që pa fajin e dëshirën e tyre janë të detyruar t'i lënë vatrat e tyre për t'u ikur përndjekjeve dhe për të shpëtuar jetë; së dyti, për shkak se si anëtare e denjë e komunitetit të shteteve të lira, Kosova e respekton të drejtën ndërkombëtare dhe obligimin që rrjedh nga ajo për mos t'ua mbyllur derën refugjatëve; dhe e treta, për shkak se ne duhet t'u qëndrojmë miqve tanë, e sidomos Shteteve të Bashkuara në krah, ashtu siç na qëndruan ata neve në të mirë e në të keq", është shprehur presidentja.

Ajo ka sqaruar se qytetarët afganë do ta kenë të kryer të gjithë vlerësimin e sigurisë nga ana e Shteteve të Bashkuara, duke shtuar se ata do të qëndrojnë vetëm përkohësisht në Kosovë derisa të rregullohet dokumentacioni i tyre për vizat e

emigrimit për në ShBA, ku do të vendosen pastaj. "Qeveria e Kosovës, menjëherë pas kërkesës dhe diskutimit e dakordimit institucional, ka formuar grupin punues që merret me çështjet organizative bashkë me partnerët tanë amerikanë. Ka qenë kërkesë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që kjo çështje të mbetet konfidenciale për arsye të sigurisë dhe të procesit të largimit të qytetarëve afganë nga Afganistani. Si të tillë, ne e kemi respektuar këtë kërkesë, por punën nuk e kemi ndalur", ka bërë me dije Osmani. Më tej, ajo ka vlerësuar se më mirë se qytetarët e Kosovës nuk e di askush çfarë do të thotë të dëbohesh e të largohesh me dhunë nga vendi ku je rritur. "Atëherë, shumë vende anembanë botës hapën dyert për ne pa asnjë kërkesë e asnjë kusht. Na shpëtuan. 22 vjet pas atij tmerri,

Zgjedhjet lokale, 29 subjekte politike aplikuan në KQZ

Prishtinë, 15 gusht - Subjekteve politike që duan të marrin pjesë në zgjedhjet e tetorit i ka mbetur vetëm edhe dita e hënë për të aplikuar në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). Zyrarë të KQZ-së kanë bërë me dije se janë duke punuar edhe gjatë ditëve të fundjavës për t'i pranuar aplikimet e subjekteve

politike për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 17 tetor. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "KosovaPress" se KQZ-ja ka pranuar 29 subjekte politike, ku gjashtë nga ato janë parti politike, dhjetë janë iniciativa qytetare dhe trembëdhjetë të tjerë janë kandidatë të pavarur.

"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar aplikimin e 29 subjekteve politike, prej këtyre gjashtë janë parti politike, dhjetë iniciativa qytetare dhe trembëdhjetë kandidatë të pavarur. Në përgjithësi numri i kandidatëve të cilët përcaktojnë këto subjekte politike është 34

kandidatë për kryetarë të komunave të ndryshme, si dhe 474 kandidatë për kuvende të ndryshme komunale. Afati i aplikimit të subjekteve politike, pra dhe njëkohësisht për të dorëzuar listën me emrat e kandidatëve, është data 16 gusht dhe deri në orën 16:00



KQZ-ja do t'i presë aplikimet e subjekteve politike", ka thënë Elezi.

tani Kosova do të dëshmojë se ne kurrë nuk e humbim njerëzoren brenda nesh. Populli ynë i urtë thotë: 'Shtëpia është e Zotit dhe e mikut'. Me këtë mirëseardhje ne duhet t'i presim miqtë tanë për të shpëtuar jetë, ashtu siç na shpëtoi bota demokratike kur patëm më së shumti nevojë. Kosova gjithnjë do të jetë në anën e humanizmit, paqes dhe demokracisë", ka shkruar presidentja Osmani.

Edhe opozita pro pranimit të afganëve

Para se të bëhet me dije qëndrimi i institucioneve të Kosovës, subjektet opozitare janë shprehur për strehimin e qytetarëve afganë në Kosovë. Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se Kosova duhet të tregojë zemërgjerësi dhe të pranojë një numër refugjatësh nga Afganistani. "Ne në Kosovë e dimë shumë mirë ndjenjën e pafuqisë që vjen në çastin kur dëbohesh dhunshëm nga shtëpia. Dhimbjen dhe pasigurinë që të kaplon kur ndahesh pa dëshirë nga gjithçka që njeh dhe do. Sot, Kosova e vogël dhe me resurse të limituara, duhet të tregojë zemërgjerësi dhe të pranojë një numër të refugjatëve nga Afganistani", ka shkruar Çitaku në profilin e saj në "Facebook". Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, u ka bërë thirrje

institucioneve të Kosovës t'i pranojnë refugjatët afganë. "Kosova të jetë vullnetare për strehimin e disidentëve afganë dhe të jetë pranë Shteteve të Bashkuara të Amerikës ashtu siç ishin ata pranë nesh, kur riatdhesuam shtetasit e Kosovës nga Siria", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ditë më parë agjencia "Reuters" ka raportuar se qeveria amerikane ka zhvilluar bisedime të fshehta me Shqipërinë dhe Kosovën për t'i strehuar përkohësisht afganët që kanë punuar me forcat amerikane në Afganistan. Burimet e kësaj agjencie kanë deklaruar se Shtetet e Bashkuara i kanë ofruar Kosovës favore ekonomike dhe politike për marrjen e disa mijëra afganëve. Por, diplomatët amerikanë kanë thënë se në Uashington ka shqetësime për aftësinë e Kosovës që t'i strehojë afganët.

Të dielën edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka treguar se Shqipëria i ka dhënë përgjigje pozitive kërkesës së Shteteve të Bashkuara për strehimin e afganëve. Madje ai kishte ftuar edhe institucionet e Kosovës që të mos refuzojnë kërkesën e ShBA-së. "Nuk e di nëse amerikanët i kanë kërkuar edhe Kosovës t'i strehojë afganët që u ekspozuan si miq dhe mbështetës të ushtrive aleate. Uroj që në rast se po, Qeveria e Kosovës të përgjigjet pozitivisht për nderin e saj e të Kosovës sigurisht", ka shkruar



Rama në profilin e vet në "Facebook". Shumë afganë që kanë punuar me forcat e huaja kanë frikë nga hakmarja e militantëve talebanë për shkak të punës së tyre. Departamenti Amerikan i Shtetit ka shpallur një program të ri i cili u mundëson mijëra afganëve mundësinë të zhvendosjen si refugjatë në ShBA. Mijëra afganë që do të jenë pjesë e këtij programi duhet të barten në

një shtet të tretë dhe të presin për 12 deri në 14 muaj derisa të analizohet gjithë aplikacioni. Pas tërheqjes së ushtrisë amerikane nga Afganistani, militantët talebanë kanë marrë shumicën e qyteteve. Të dielën ata kanë filluar të hyjnë nga të gjitha anët në Kabul dhe janë pranë marrjes së kryeqytetit. Presidenti i Afganistanit, Ashraf Ghani, është larguar nga vendi. "Reuters"-i ka raportuar se Ghani është larguar

për në Tashkistan, ndërkaq nga zyra e tij kanë thënë se nuk mund të komentojnë për këtë informacion "për arsye të sigurisë". Ambasada Amerikane dhe misionet e tjera diplomatike të shteteve evropiane kanë përsheptuar të dielën përpjekjet e tyre për ta evakuuar stafin e ambasadave. Talebanët deri më tani kanë nën kontroll 25 provinca nga 34 sa janë gjithsej në Afganistan.

Gara rajonale për zhvillimin e ekonomisë, Kosova e para për rritjen e PBB-së për vitin 2021



PRISHTINË, 15 GUSHT - Në garën rajonale për zhvillimin e ekonomisë, Shqipëria vazhdon të tregojë rritje të ndjeshme ekonomike. Banka e Shqipërisë në raportin e fundit të saj ka bërë krahasim të situatës mes vendeve si Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia në gjashtë muajt e parë të vitit 2021. Sa i

përket rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), Kosova zë vendin e parë me 5.6 për qind e më pas Shqipëria e 0.1 pikë më pak. Pozitivisht ka ecur edhe Serbia me një rritje prej 1.7-përqindësh, ndërsa Shkupi ka një trend ende negativ. Sa i përket inflacionit vjetor, është Serbia që mban

vendin e parë me 3.2 për qind, ndërsa Shqipëria zë vendin e fundit. Ky tregues vlen si për ta matur ecurinë e konsumit, por edhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë. Papunësia në Shqipëri, sipas Bankës Qendrore, u rrit 0.5 për qind. Por, sipas të dhënave

zyrtare, nivelin më të lartë e ka Kosova me 27 për qind dhe Maqedonia e Veriut me 16 për qind. Beogradi dhe Tirana kanë një trend thuajse të njëjtë. Banka e Shqipërisë, duke analizuar uljen e normës së interesit për kreditë hipotekare dhe për bizneset, parashikon vazhdimin e rritjes së

qëndrueshme të ekonomisë, kjo e shoqëruar me rritjen e besimit pas heqjes së kufizimeve për parandalimin e pandemisë së koronavirusit. Edhe në tregjet ndërkombëtare, nënvizon institucioni qendror bankar, shënohet një zhvillim i fortë i ekonomisë i shoqëruar edhe me rritjen e konsumit. (Ora News)

Ame e bir, rrezeditë, nga Buroja, n'Amerike!



NANA ME 4 DJEM, NË BURGUN E HAGËS?!

Shkruan: Riza GREIÇEVCI

Kush je ti, bre? Heu?
 Toka e qielli me njohin!
 Jam nanë!
 Për ku je nisur?
 Dua me shkue me fol me Zotin!
 Një nanë don me fol me Zotin?
 A ke lejehyrje? Heu?
 A edhe të Zoti me shkue duhet lejehyrja, a?
 Phuuu, bre, çka s'polli mendja e njeriut!
 Jam nanë! Jam dhuntia e Zotit!
 Veç nana, falë Zotit, përkund botën!
 Si e ke emrin? Nana e maleve, jam!
 Nana e 4 yjeve! Nana e 4 djemve!
 I rrita me kore buke...
 Kur u rritën, ua dhashë maleve...!
 Nanëmadhja e UÇK-së, me thonë:

E Drenicës, para gjyqit!
 E UÇK-së, para gjyqit!
 E Kosovës, para gjyqit!
 E gjakut para gjyqit!
 E pushkës çlirimtare, para gjyqit!
 E lirisë, para gjyqit!
 E nanave, para gjyqit!
 E vorreve, para gjyqit!
 E Zotit, para gjyqit!

Edhe e Zotit, edhe e Adem Jasharit!
 Aman, nana Hyrë, thua Zoti, para gjyqit?
 Edhe Zoti, edhe UÇK-ja, bashkë, në Hagë!
 Edhe djepat, edhe Kosova, para gjyqit?
 Po flitet, zor e paska Haga, me pasë aq vend të lirë
 në burg, sa ka lisa e plisa, sa ka nana, djem,
 sa ka istikame, sa ka Ushtarë Çlirimtarë,
 sa ka karroca të invalidëve të UÇK-së,
 sa ka pika gjaku, eshtna, varre masive,
 gjithandej Kosovës...
 A, ti, je, Nanëmadhja, Hyrë?
 Një nanë nga Drenica do me folur me Zotin?
 Due me folur me Zotin, e masanej, edhe unë
 po hyj e po rri, bashkë me 4 djemtë e mi,
 në burgun Hagës, aq sa me jep Zoti ymer!
 Po shkoj ku i kam djemtë e mi!
 Po shkoj ku e kam zemrën, shpirtin,
 ku e kam qefinin, tabutin, vorrin...
 Edhe Zoti e di, pra:
 Shaqptare jam, s'jetoj me qira në Kosovë!
 S'na solli kanjusha nga t'Anadollit konaqe,
 Jemi dardan, s'jemi me bisht,
 kemi besë, s'jemi ujç, as rob, as melaqe...!

Bijhtë e mi!
 Me këto duar u kam gatue!
 Gjuhën teme ua kam mësue!
 4 djem lapidarë!
 Gjuhë e gjak, janë shqiptar!
 Me këta sy i kam qa!
 Me këto duar i kam la!
 U dhashë tamël me këta gj!
 Qysh me dekun për liri!
 Shqip i mësova me punue!

Edhe dekun me jetue!
 Kur u rritën ia fala malit!
 U bënë krah të Adem e Jasharit!

Ç'punë ke, thua me Zotin, moj nanë?
 Dua me i kërkue një lejehyrje për Hagë!
 Dua me ia dorëzua frymën që ma fali!
 Dua me ia dorëzua, Zotit, djepin!
 Dua me ia dorëzua Zotit, gjinjtë e nanës!
 Dua me ia dorëzua tamblin e nanës!
 Due me vet Zotin, besoj, je Zoti, pse fale farën
 e kaurrit, të naletit, të lugatit, farën e shrigave,
 pse fale burgun e Hagës, pse fale rrencin, mashtruesin,

heleqarin, tradhtarin, pse fale, o Zot, aman, ç't'u desht
 fara e sllavit, e shkavit, e ciganit, gjenocidarit, ç't'u desht,
 o Zot i Madh, thika, sakica, kasapi, zagari...
 pushtuesi... robnuesi... dhunuesi...
 (shpërthen një za nane, me jehona):

(Fol Gjykatë Speciale e Hagës:
 Po bani e bani, vaki, Speciales me ia marrë tinëz,
 (kushedi, kush?), çelësat e sallave të gjykimit,
 të zyrave të gjyqtarëve...prokurorëve...
 e m'i sjell në Shoqatat e dala nga UÇK-ja, në Kosovë,
 kurse lëndët e fajësisë, UÇK-ja e pafajshme, çlirimtarët e
 prangosur, m'u kthye shëndosh e mirë, si molla, në
 Kosovë:

Çka ban, Del Ponte, Dic Martti, Serbia, aleatët e saj,
 Haga, qyqe vetëm pa UÇK-n, pa çlirimtarët,
 pa malet, pa dëshmitarët e rrëmë...?!
 Eee, çka bajnë: Evropa, Haga, Rusia...pa ty,
 Gjykytë Speciale hileqare antishqiptare, antUÇK,
 Antiliri, antipavarësi, antiKosovë?!
 Kthejnë, në Bruksel, për kryeshendosh!

Zot Ynë, të qofshim falë!
 Gjykata e Hagës, në sy bote thotë:
 "UÇK-ja, ndërmarrje kriminale!"
 Luftëtarët e lirisë, vrasës! Paskan ba krime?
 Anëtarët e UÇK-së, paskan dhunuar...?
 Moj tokë e bekuar, lëshona 77 pashë fell n'Dhe!
 Zot Ynë, djemtë e UÇK-së, paskan dhunuar nanat,
 motrat, vajzat... paskan vra fëmijë, gra, pleq serbian?
 Çlirimtarët e UÇK-së, shqiptar, me bishta?!
 Kriminelë? Hajdutë! Vrasës! Dhunues...?

T'u mylltë goja, t'u qorrofshin të dy sytë, ty,
 që hape burgun e Hagës, për djemtë e maleve!
 Ah, të marrtë Ora e ligë, jarabi!
 Ti nxjerrshin qentë eshtrat nga vorri!
 Ti që hape burgun për lirinë...gjakun...për nana...
 Ti,që polle burgun e Hagës, për bijhtë mi,
 ti s'ke fe, adhe, as Zot, hiqmu sysh, o pjellë lugati!
 E di, nana Hyrë, e din, fort mirë, rodin tan
 prej lugati,shkej s'u ngine gjak e mish e troje
 e sy, e gji, erz, dhunime të nanave, nuseve, çikave!
 O edhe matan xhehenemit, bota e di zanatin tan:

Ti ia ha mushkëritë lirisë!
 Ti Kosovën e sheh,e do, Serbi!
 Ti ia pi gjakun Pavarësisë!
 Ti lyp me ia qorrue sytë, shtetit të Kosovës!
 Ti kërkon me ua pimun pikë, rritën, dashurinë,
 lumturinë e fëmijë të mi!
 Ti i do pendlat e korbit, në lëkurën e Shqiponjes!
 Ti kërkon me shpall engjëll, thikën!
 Ti kërkon me shpall, Kasapin e Ballkanit, mbret!
 Tli don me zhba: lirinë, UÇK-n, Pavarësinë, shetin e
 Kosovës, e, me Gjykata e gjykime, me ligje e dëshmitarë
 të rrëmë, me zagarë, me kryma, me huta, me kudra,
 dhelpra, me kukuvajka, qyqe, don me rikthye "Kosovë –
 Metohinë", ushtrinë serbe, shtetin, thikën,
 gjenocidin, gjyqet, ligjet, burgjet...me kin "demokracinë",
 Rusinë... Ti kërkon me hangër mishin, me pi gjakun
 me shlye emrin e UÇK-së! Me ia zi eshtnat! Me ua qit
 qenve! UÇK-së, e ia shkoq emrin nga truni,
 nga gjaku, nga Kosova, nga Shqipëria...

UÇK – kryt nalt me ngrit, kemi Zotin: Amerikë!
 Nana t'i jep nana sytë e mi!
 Ta jep, nana Hyrë, zemrën teme!
 Ti jep nana musknitë e mia!
 Ti jep nana, duart e mia!
 Ta jep nana gjakun tem!

Ta jep nana ashtin tem!

A je ti DicMarti i Hagës, a po me bajnë sytë?
 A je ti, gjyshja e del Pontes?
 A koke nana, motra, dadoja e Speciales...?
 Pu-pu-puuu! Larg gojës teme!
 T
 Ti lugat, me 12 krena, i dale nga xhehenemi?
 O Zot! Shkundulloje qiellin, e bën hata:
 Rrënoje 7 pashë në Dhe, padrejtësinë! Rrenën! Shpifjen!
 Hilën dhe kilen!
 Rrëzohu o qiell e ban hata!
 O male! Shtypeni mizorin, mos kini rahmet!
 Ndrydhne, shtypne, o shtypne, bre, shtypne,
 se shtypja mbi shtypësin:
 Drejtësi! Trimni! Liri! Marifet! Xhenet!
 Hagë, o gur i ranë, edhe burg, edhe plagë...
 Jam nanë! Nana Hyrë! Jam nana e 4 djemve
 (zëri drithërues i nanës, shpërthen me jehona):
 Haaaashim, biiiii! Jakuuuu!Kadriiii! Rexheep!
 Hallall e paçi temblin e gjinit, që ua dha nana!

Nuk jam vetëm, bijhtë e mi!
 Me mue erdhen malet, istikamet, Abria,Likoci, Qyqevica,
 Meja, Reçaku, Pakleku, Izbica,
 Malet e Berishës...Vlora, Kruja...
 Edhe Prekazi erdhi me Drenicën... edhe Kongresi i
 Manastirit...edhe Pashriku... edhe Kaçaniku e Dukagjini...
 bashkë me mue erdhën, këtu në Hagë:
 Kosova! Endriti! Me Lumen! Me gjyshin Haxhi!
 Me Drenicën! Me mue erdhën sytë e mi! Ashti im!
 O djemtë e UÇK-së, zot e për mi zot të maleve,
 të pushkës çlirimtare...të lirisë...Pavarësisë...
 O të bekuemit e Zotit,djemtë mi!
 Bashkë me nanën Hyrë, që, afër nanës, UÇK-ja,
 po i prin Adem Jashari, krah për krah
 me Drenicën, Kosovën,Shqipërinë!
 Janë ardh me ju marrë, juve,o bijhtë e mi...!

Jo, i thashë Hagës.Edhe Zoti i thashë, jo!
 Unë, nana Hyrë, ma nuk kthehet e gjallë në Drenicë!
 Burgu i Hagës e ka edhe një vend të lirë
 për nanën Hyrë...me veti e kam marrë qefinin, tabutin,
 një grusht Dhe Buroje, ujë të bunarit, kam marrë me veti
 pak Dhe të vorrit të babës e të nanës sime...
 E mora edhe plisin e gyshit, furkën e boshtin e gyshe!
 O edhe nana Hyrë, do hyjë e do rri, në terrin e Hagës,
 bashkë, me 4 bijhtë e mi, që 12 muaj, se janë shqiptar, se i
 prinë UÇK-së, se janë dora e Zotit, nderi Kombit!
 O trupin tim, të pa pajetë, të mos e varrosin
 në Dheun Hagës, po midis deti...

(Shpërthej melodi e Marshit të UÇK-së, nanës Hyrë,
 i doli klapia e komës, mori vesh se ishte në Spitalin
 e Prishtinës,afër saj zgërdhihej exheli...!)

Zërin e Zotit: "Djemtë e tu,o nanë,
 plotësisht të pafajshëm!"



(Zani me jehona, nga bugu i Hagës,
 i 4 Heronjve të Luftës Çlirimtare e të Paqes):

Ushtrinë e ke!
 Lirinë e ke!
 Pavarësinë e ke!
 Shtetin e ke!
 Paqen e ke!
 Lavdinë e UÇK-së e ke!
 Kosovë:
 Hallall gjaku ynë!

Publicisti Greiçevci pasuron bibliotekën e "Epokës së re"

Prishtinë, 15 gusht (ER) - Shkrimtari dhe publicisti Riza Greiçevci ia ka dhuruar sot bibliotekës së gazetës "Epoka e

re" pesë ekzemplarë të veprave të botuar kohën e fundit në lidhje me Gjykatën Speciale në Hagë. Veprat i ka pranuar

drejtori i gazetës, Sadik Zeqiri, i cili ka falënderuar Greiçevcin në emër të "Epokës së re", duke i uruar punë të palodhshme. "Z.

Greiçevci i urojmë që mos ta ndalë pendën, por të vazhdojë të shkruajë sa më shumë", ka thënë Zeqiri.



KOSOVA TË DIELËN KA REGJISTRUAR KATËR VIKTIMA DHE 1 096 RASTE TË REJA ME COVID

Rritet numri i pacientëve me Covid që po trajtohen në spitalet e Kosovës

Të dielën autoritetet shëndetësore kanë njoftuar se janë regjistruar katër viktima dhe 1 096 raste të reja me Covid. Viktimat janë nga komuna e Gjakovës, e Vitisë, e Skenderajt dhe e Rahovecit. Ndërkaq Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka njoftuar se 325 pacientë marrin trajtim në klinikat për Covid-19 dhe spitalet e përgjithshme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 GUSHT - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të dielën se 325 pacientë po trajtohen në klinikat për Covid-19 dhe spitalet e përgjithshme dhe 256 prej tyre janë pozitivë me koronavirus. Kjo statistikë paraqet një rritje të numrit të pacientëve të shtrirë në spitale krahasuar me një ditë më parë, kur ishin të shtrirë 272 pacientë, 196 prej tyre pozitivë me Covid-19. ShSKUK-ja ka theksuar se 11 pacientë janë në gjendje të rënduar, ndërkaq 242 po trajtohen me oksijenoterapi. Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Klinika Infektive ka më së shumti pacientë, përkatësisht 86, pasuar nga ajo e Pulmologjisë në të cilën po trajtohen 39 pacientë. Në spitalet e përgjithshme po trajtohen 164 pacientë me Covid-19, ku 59 prej tyre janë të shtrirë në spitalin Gjakovës, 36 në atë të Gjilanit, 35 në atë të Prizrenit dhe

pjesa tjetër në spitalet e tjera të përgjithshme në Pejë, Mitrovicë, Vushtrri dhe Ferizaj.

Të dielën nga 7 953 testime, 1 096 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar katër rast të vdekjes. Viktimat janë nga komuna e Gjakovës, e Vitisë, e Skenderajt dhe e Rahovecit. Numri më i madh i të infektuarve i përket grupmoshës 20-29 vjeç, përkatësisht 332 raste të reja. Po ashtu, 210 persona të



grupmoshës 30-39 vjeç janë infektuar në 24-orëshin paraprak. Ndërkaq, Prishtina ka regjistruar

më së shumti raste, përkatësisht 267. Po të dielën janë shënuar edhe 53 qytetarë, derisa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 106 109. Në total numri i rasteve aktive është 7 854.

Gjobiten 117 qytetarë për mosrespektim të masave kundër pandemisë

Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka shqiptuar gjoba ndaj 117 qytetarëve të cilët nuk kanë respektuar masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Tiketa të shqiptuara në bazë të Ligjit Covid-19 janë 117", thuhet në raportin e Policisë së Kosovës, ku nuk specifikohen shkeljet që i janë bërë këtij ligji.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë së Covid-19 është miratuar në muajin gusht të vitit të kaluar. Gjobat për mosrespektim të këtij ligji fillojnë nga 35 deri në 2 000 euro, varësisht nga shkeljet. Nga dita e shtunë, 14 gusht, Policia e Kosovës ka bërë me dije se do të jetë aktive për realizimin dhe zbatimin masave të reja në luftën kundër

pandemisë së koronavirusit, të cilat janë vendosur më 12 gusht nga Qeveria e Kosovës. Në mesin e masave, bartja e maskës është bërë e obligueshme, përveç rasteve kur një person ecën vetëm në ambient të jashtëm, gjatë ngasjes së automjetit vetëm apo në grup me jo më shumë se katër persona, apo gjatë ushtrimeve fizike.

Ali Nimanaj, kandidat i PDK-së për kryetar të Istogut



PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka bërë me dije se kandidat i kësaj partie për kryetar të Istogut është Ali Nimanaj. "Komuna e Istogut i ka të gjitha parakushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Me bjeshtë e natyrë të mrekullueshme, me qytetarë punëtorë, Istogu duhet të transformohet në vend turistik që siguron mirëqenie shumë më

të mirë për gjithë të rinjtë e të rejtat, pa dallim", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook". Krasniqi ka thënë se kandidati i PDK-së për kryetar të Istogut, Ali Nimanaj, e ka vullnetin dhe potencialin që të punojë për ndryshimin e modelit të qeverisjes në Istog. "PDK-ja do të hapet për t'u krijuar hapësirë vendimmarrësve profesionistë

të rinj, në njërin prej komunave më të bukura që ka Kosova. Ne do ta mbështesim Ali Nimanajn për t'i zbatuar prioritetet e qytetarëve, për reforma rrënjësore me transparencë e llogaridhënie të plotë", ka shkruar Krasniqi. Ai një ditë më parë ka zyrtarizuar edhe Leonora Morina-Bunjaku, kandidate për kryetare të Gjilanit dhe Bekim Azizin për kryetar të Vitisë.

Jasharaj: SBASHK-u nuk do t'i mbrojë mësimdhënësit që nuk vaksinohen

PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se kjo sindikatë nuk do t'i mbrojë mësimdhënësit që nuk vaksinohen nëse ndaj tyre

qeveria merr ndonjë masë ndëshkuese. Ai u ka bërë thirrje të gjithë mësimdhënësit që gjatë këtij muaji të imunizohen kundër Covidit në mënyrë që të mos rrezikohet fillimi i vitit të ri shkollor. "Ata që nuk vaksinohen

për tekat e tyre ose për ndonjë teori konspirative, SBASHK-u nuk do t'i mbrojë të tillët në qoftë se institucionet marrin masa kushtëzimi apo, më vonë, edhe masa ndëshkuese", ka thënë Jasharaj për "Kosovapress".



Bajrami, Kurtit: Asnjë vendim nuk e keni marrë për ta ndihmuar ekonominë

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka reaguar pas deklaratës së kryeministrit Albin Kurti, i cili ka thënë se qarkullimi i bizneseve në gjashtë muajt e parë të këtij viti ka shënuar rritje prej 30-përqindësh. Ajo i ka thënë Kurtit që kur të flasë për shifra duhet të jetë gjithëpërfshirës. "Po e ofendon çdo qytetar me këta numra dhe me këto lëvdata, më së shumti je duke i ofenduar ata që vitin e kaluar e kanë blerë një litër vaj 0.99 centë e sot e blejnë 1.55 euro centë. Normal se ka 34 për qind më shumë se vitin e kaluar të hyra nga tatimi në të

ardhurat e korporatave, sepse vitin e kaluar vendi ka qenë i mbyllur e shumica e korporatave nuk kanë pasur mundësi të shesin asnjë produkt nga 11 marsi deri më 5 qershor. Normalisht se ka 37 për qind më shumë TVSh të mbledhur se vitin e kaluar, sepse vitin e kaluar vendi ka qenë i mbyllur. Normalisht se ka 95 për qind më shumë tatim në pronë të mbledhur këtë vit sepse vitin e kaluar qytetarët, për shkak të mbylljes, as që kanë pasur mundësi ta paguajnë tatimin në pronë", ka shkruar Bajrami në llogarinë e saj në "Facebook". Ajo ka parashtruar edhe disa



pyetje për kryeministrin Kurti. "Qysh po e shpërndan pakon e ringjalljes 420 milionë euro? Qysh ka me u zhvillu mësimi nga data 1

shtator? Si ka mundësi që jemi vendi me më se paku të vaksinuar në rajon? Kush i ka 'meritat' që i kemi mbi 1 300 të infektuar në ditë? A po shkojmë drejt mbylljes totale? Si keni për t'i ndihmuar bizneset e qytetarët kur ta mbyllni vendin? Trego për të ardhmen, se në ekonomi krejt çka po ndodh është meritë e madhe e bizneseve, qytetarëve, konsumit që vjen nga mërgimtarët tanë, masat e rimëkëmbjes ekonomike të qeverisë së kaluar dhe natyrisht inflacionit. Asnjë vendim nuk e keni marrë për ta ndihmuar ekonominë", ka thënë ish-ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami.

Murati: Kapitali i diasporës mund të shfrytëzohet për investime dhe projekte zhvillimore



PRISHTINË, 15 GUSHT - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se kapitali i diasporës mund të shfrytëzohet edhe për investime, por edhe për projekte zhvillimore. Kjo, sipas

tij, mund të arrihet përmes bonove të diasporës, ide kjo e dalë nga plani për rimëkëmbje ekonomike. "Synim ynë është që përmes krijimit të këtij instrumenti, do të thotë të kësaj mundësie për të

kanalizuar apo për të orientuar kapitalin e diasporës", ka thënë Murati në një intervistë për emisionin "7 Ditë me Panxhën". Sipas Muratit, përmes investimeve në bonot e diasporës do të mundësohen

dy gjëra: "Do të mundësohet që kapitali të investohet në projekte zhvillimore dhe jo vetëm në konsum që rrit deficitin tregtar. Dhe që mërgata të ketë përfitime nga ky investim. Pra të mos

trajtohet vetëm si një obligim që ka për t'i mbështetur familjarët këtu. Pra, pa pritur ndonjë kthim ose për ta mbështetur shtetin siç ka ndodhur edhe në të kaluarën", ka deklaruar ministri Murati.

Rukiqi: Rimëkëmbja ekonomike, e varur nga vaksinimi

PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se rimëkëmbja ekonomike nuk mund të ndodhë pa arrijen e imunizimit nga Covid-19. Ai ka thënë se kohën e fundit ka rritje të qarkullimit dhe kjo sigurisht do të reflektohet në buxhetin e vendit. "Nga bisedat me bizneset vërehet se ka rritje të qarkullimit dhe kjo sigurisht do të reflektohet në buxhetin e vendit dhe në

gjendjen financiare të kompanive. Jemi në proces të rimëkëmbjes. Po i referohem rritjes së qarkullimeve të bizneseve këtë vit dhe rritjes së eksporteve dhe të hyrave buxhetore. Mirëpo prapë nuk mund të flasim pa e pasur një përfundim zyrtar të pandemisë Covid-19", ka thënë Rukiqi për "Ekonomia Online". Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen pasi, sipas tij, nuk ka

rimëkëmbje ekonomike pa imunizim. "Nëse dëshirojmë ta shohim pjesën e rimëkëmbjes dhe të kemi plane afatgjata të zhvillimit këtë nuk mund ta bëjmë pa e pasur një situatë më të mirë të vaksinimit dhe kjo është thirrje për të gjithë ata që po hezitojnë të vaksinohen, sidomos tani kur ka mundësi edhe të zgjedhjes së vaksinës dhe të mos jenë pengmarrës të zhvillimit të vendit", ka thënë Rukiqi.



Historia e errët e Kullës së Londrës



Sot është një simbol i famshëm i Britanisë së Madhe, një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO -s që nga viti 1988. Por kur u ngrit në vitin 1080, ishte sinonim i shtypjes së huaj. Në fakt në fillim Kulla e Londrës ishte fortesa e ndërtuar me porosi të Uilliam Pushtuesit, Duka i Normandisë.

Pasi mundi Haroldin, mbretin e anglosaksonëve, në Betejën e Hastings në vitin 1066, padronit të ri të ishullit iu desh të ruante kontrollin dhe të shtypte çdo rebelim. Kulla e parë (e quajtur Kulla e Bardhë që nga shekulli i 13-të, dhe aktualisht ndërtesa kryesore e kompleksit) kishte pikërisht këtë synim: të ruante qasje në lumin Tamiz dhe t'u kujtonte të gjithëve fuqinë normane.

Teksa i është nënshtruar riparimeve të vazhdueshme, Kulla është përdorur gjithmonë, dhe tregon ende sot të gjithë qëndrueshmërinë e saj. Kjo është arsyeja pse aty ruhen xhevahirët e Kurorës Angleze. Por në të kaluarën Kulla ka qenë një pallat

mbretëror, arkiv shtetëror, dhe në disa raste një burg nga i cili ishte e pamundur arratisja.

Burgu i armiqve të Kurorës Britanike

Për një kohë të gjatë britanikët e panë me respekt kullën që dominonte horizontin mesjetar të Londrës. Hyrja në të ndodhej në katin e dytë nga tre katet gjithsej. Por shkallët mund të hiqeshin me shpejtësi në rastin e një sulmi.

Një shembull i shkëlqyer i arkitekturës mesjetare me funksione të dyfishta ushtarake dhe politike, Kulla e Londrës u rrethua disa herë. Por famën më të madhe e fitoi si burg dhe jo si fortesë. Këtu janë burgosur armiqtë e shtetit (Tomas Mor, u burgos në vitin 1534 dhe më pas iu pre koka), apo të afërm të sikletshëm të familjes mbretërore: Ana Bolena, gruaja e dytë e Henrit VIII, së cilës po ashtu iu pre koka në kullë, si dhe Kethtrin Hauard dhe Ledi Xhejn Grej. Në

tërësi, në kullë janë burgosur 4 mbretëresha të Anglisë dhe vetëm njëra, Elizabeta I (e burgosur nga Meri Gjakatarja), doli gjallë prej andej.

Por viktimat më të shquara të kullës ishin dy princat Eduard dhe Riçard, djemtë e Eduardit të IV të Jorkut. Ato ishin kohët e errëta të Luftës së Trëndafilave dhe vëllezërit e vegjël, përkatësisht 12 dhe 9 vjeç, u mbyllën në kullë në vitin 1483. Për fatin e tyre nuk pati më asnjë lajm.

Nuk ka prova të sigurta se ata u vranë në kullë. Megjithatë kulla u quajt më vonë Kulla e Përgjakshme. Për ata që burgoseshin në Kullën e Londrës, vdekja mund të ishte një çlirim. Gai Fouks, atentatori që u përpoq të hidhte në erë Mbretin Xhejms I dhe deputetët në vitin 1605, u torturua për 2 ditë rresht para se të ekzekutohej.

Stolitë e monarkisë

Kulla është modifikuar shumë herë. Si kala doli jashtë funksionit me përhapjen e topave, por

vazhdoi të ishte një nga vendet simbol të fuqisë së Anglisë. Ishte rezidenca mbretërore deri në shekullin e VII, dhe vendndodhja e thesarit të Madhërisë së Tij deri në fillim të shekullit XIX.

Pastaj ishte një kopsht zoologjik privat deri në vitin 1835. Ndërkohë, vazhdoi të mbante brenda garnizone ushtarësh dhe depo armësh, dhe që prej vitit 1303 stolitë e Kurorës. Kur një hajdut i vodhi ato nga Abej Uestminster, u zhvendosën në atë që besohej të ishte vendi më i sigurt në mbretëri. 23.578 objekte të çmuara, përfshirë diamante, ar dhe gurë të çmuar të grumbulluar nga sovranët anglezë gjatë shekujve, ndodhen ende në Kullën e Londrës, të ekspozuara edhe për sytë e turistëve. Në të kaluarën ato ishin edhe më shumë, por një pjesë e konsiderueshme e koleksionit u shpërnda gjatë viteve të luftës civile dhe Republikës, në shekullin XVII.

Por po aq të famshëm sa fortesat janë edhe rojet e saj, Beefeaters, me uniformën e tyre tipike të kuqe. Ata e kanë marrë këtë emër për shkak

të dietës së tyre tradicionale me bazë mishi. Në fakt mbetet ende një pozicion prestigjioz dhe i mirë-paguar, edhe pse privilegjet e të kaluarës janë vetëm një kujtim i largët. Më shumë sesa roje, Beefeaters punojnë tani si guida turistike.

Peripecitë e Urës së Londrës

Nga dritaret e Kullës mund të shihni Urën e Londrës, një tjetër simbol ikonë i qytetit, e ndërtuar shumë më vonë. Ura e Londrës u hap për herë të parë më 1 gusht 1831. Në ceremonimori pjesë edhe familja mbretërore, që ofroi një banket në një pjesë të strukturës. Por Ura e Londrës, nisi të fundosej me 3 centimetra në vit. Ndaj në vitin 1968, iu shit një biznesmen amerikan, që e çmontoi tullë pas tulle dhe e rindërtoi në Arizona, ku u bë atraksioni i dytë turistik në atë shtet pas Kanionit të Madh. Ndërsa një urë tjetër e Londrës u ndërtua dhe përrua në vitin 1973. / Focus – Bota.al




**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

FBK-ja organizon edhe një ngjarje madhore

PRISHTINË, 15 GUSHT - Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) iu besua edhe një ngjarje madhore, siç është FIBA European Challenger për U16 te meshkujt. FBK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet e mundshme për Evropianin që do të zhvillohet në Prishtinë. Nga dita e hënë deri të shtunën (përveç të enjtes që është ditë e lirë) do të zhvillohen tri ndeshje në ditë. Sfidat hapëse është të hënën Shqipëria-Gjibraltari nga ora 14:00, kurse sfida hapëse për Kosovën është ndaj Maltës nga ora 17:00. Nga ora takohen Moldavia - Luksemburgu. Mediat dhe mysafirët do të vendosen në Zonën 3, prapa koshave, kurse do të lejohen 15 % të kapacitetit të palestrës për tifozët. Të gjithë të pranishmit në palestër duhet të mbajnë maska dhe ta ruajnë distancën sociale. Përveç Kosovës

janë akomoduar edhe Shqipëria, Luksemburgu, Gjibraltari, Malta dhe Moldavia. Të gjitha ekipet janë testuar dhe lojtarët dhe stafi kanë rezultuar negativë në testin bërë për koronavirus. Ndërkohë, basketbollistët e Kosovës U16, pas përgatitjeve intensive, janë të gatshëm për këtë garë shumë të rëndësishme.

Federatës së Basketbollit të Kosovës iu besua edhe një organizim i veçantë, pasi më herët kishte organizuar Evropianin e Divizionit C për U18 te meshkujt më 2018, Evropianin e Divizionit B për U20 te femrat më 2019 dhe në shkurt të këtij viti organizoi parakualifikimet për Kupën e Botës 2023 ku, përveç Kosovës, morën pjesë edhe Islanda, Luksemburgu dhe Sllovakia. Për këto organizime mori lëvdata edhe nga FIBA.



Vesa Gjinaj shpallet kampione e 'Neocom Open 2021'

PRISHTINË, 15 GUSHT - Vesa Gjinaj është shpallur kampione në turneun e tenisit "Neocom Open 2021". Në turneun i cili është mbajtur në Shkup, tenisistja nga Kosova e ka zënë vendin e parë, derisa u kurorëzua edhe me titull. Në finale Gjinaj e ka mposhtur kundërshtaren nga Maqedonia e Veriut, Aleksandra Simeva.

Tenisistja e Kosovës fitoi 2-1 me sete (6:4 2:6 6:3). Në gjysmëfinale e ka mposhtur italianen Sara Milanese 6-3 3-6 7-5, kurse Vesa në çerekfinale kishte mposhtur Asli Ozcan me rezultat 6-4 dhe 6-1. Para saj ajo kishte eliminuar edhe bartësen e tretë të turneut, Sara Panteliç, me rezultat 6-4 dhe 6-4 me sete.



Batatina: Jemi gati për ta fituar Superkupën

PODUJEVË, 15 GUSHT - Ndeshja e Superkupës së Kosovës në futboll do të zhvillohet të martën më 17 gusht në stadiumin "Fadil Vokrri". Në këtë ndeshje përballen kampionia në fuqi, Prishtina dhe fituesja e Kupës, Llapi. Presidenti i Llapit, Beqir

Batatina, është optimist se skuadra nga Podujeva do të dalë triumfuese derisa ka kërkuar përkrahje nga i gjithë qyteti. "Kjo ndeshje i paraprinë nisjes së edicionit të ri 2021/22 dhe shpresojmë ta nisim mbarë. Ne jemi të bashkuar dhe të

përgaditur maksimalisht për të triumfuar në këtë ndeshje. Presim përkrahje nga gjithë qyteti, gjithë tifozët që të bashkuar ta sjellim trofeun e dytë me radhë në Podujevë. Së bashku ia dalim për Llapin tonë", ka thënë Batatina.

Drita transferon Tahirin nga Besa

GJILAN, 15 GUSHT - Skuadra e Dritës nga Gjilani e ka kryer edhe një transferim tjetër. Fjala është për ish-lojtarin e Besës së Pejës, Ardit Tahiri. "Ardit Tahiri është lojtari më i ri i klubit tonë. Arditi është pritur nga drejtori sportiv i klubit,

Valon Zymberi, i cili i ka dëshiruar mirëseardhje në klub. Arditi vlerësohet si një futbollist me perspektivë dhe do të jetë pjesë e grupit tonë për t'i dhënë freski dhe forcë shtesë sulmit të Dritës. Arditi deri më tani ka qenë pjesë e FC

Besa nga Peja, ndërsa pas paraqitjeve të mira ka bindur që të bashkohet me ne. Drita e sheh si talent të së ardhmes dhe tashmë është arritur kontrata trevjeçare në mes të lojtarit dhe klubit", thuhet në njoftimin e Dritës.



Vdes legjenda e Gjermanisë, Gerd Muller

MUNCHEN, 15 GUSHT - Ka vdekur në moshën 75 vjeçe legjenda e Bayern Munchenit, Gerd Muller. Njoftimin për vdekjen e tij e dha klubi gjerman. “‘Bomberi i kombit’, i cili erdhi në FC Bayern në verën e vitit 1964, fitoi një

herë Kupën e Botës, tri herë Kupën e Kampionëve Evropianë dhe një herë Kupën Evropiane. Ai ishte, gjithashtu, katër herë kampion i Gjermanisë dhe katër herë fitues i Kupës DFB. Me ekipin kombëtar ai u bë


kampion evropian më 1972 dhe kampion bote më 1974, duke shënuar golin e fitores në finalen në Munchen kundër Holandës. Pas karrierës së tij ai qëndroi me klubin për një kohë të gjatë si trajner për fushën e të rinjve. Ai

lë pas gruan e tij Uschi dhe një vajzë”. Mulleri gjatë karrierës së tij ka gjithsejtë 566 gola në 607 ndeshje konkurruese për FC Bayern. Ai, po ashtu, ka vendosur një rekord prej 365 golash në Bundesliga.



Guardiola: Kloppit, nëse s'i pëlqejnë shpenzimet e Cityt, të na hedhë në gjyq

MANCHESTER, 15 GUSHT - Rivaliteti mes Jurgen Kloppit dhe Pep Guardiols ndizet me thumbimet që të dy trajnerët i bëjnë njëri-tjetrit me deklaratat për shtyp. Gjermani i “The Reds” pak ditë më parë u shpreh se për Guardiolen nuk ka kufizime sa iu përket blerjeve të shtrenjta, duke nënkuptuar se kolegu i tij i Citizens ka një avantazh të theksuar dhe të padrejtë. Pikërisht ky qëndrim i Kloppit ka nxitur reagimin e spanjollit, që në konferencën për shtyp para përplasjes me Tottenhamin ironizoi rivalin e tij duke u shprehur se “duhet t'i hedhë në gjyq” nëse nuk i pëlqejnë blerjet e shtrenjta të Manchester Cityt. Pep beson se Manchester City po i përmbahet protokollit të “Fair Play Financiar” dhe se shpenzimet për blerjet janë thjesht rezultat i dashamirësisë së pronarëve për klubin e tyre. “Më parë kishte vetëm një ose dy klube. Tani është Chelsea me Roman Abramovichin dhe klubi ynë me Sheikun Mansour. Ata duan të bëjnë shpenzime në futboll. Cili është problemi? Ne kemi kufizime për



‘Fair Play Financiar’ dhe nëse ka nga ata që nuk pajtohen me shpenzimet e Citizens, mund të shkojnë në gjykatë dhe të bëjnë ankesë”, ka thënë Guardiola. “Kemi blerë Jack Grealish, sepse kemi arkëtuar 60 milionë nga shitjet, kështu që, në fund të fundit, kemi shpenzuar vetëm 40 milionë. Ne ndjekim absolutisht rregullat. Në klubin tonë pronarët nuk duan të humbasin para natyrisht, por ata duan të shpenzojnë, kështu që ne mund ta

bëjmë atë. Vite më parë, kur Manchester United fitonte shumë trofe sepse shpenzonte më shumë se klubet e tjera. A e mbani mend këtë? Në atë kohë Manchester City nuk mund ta bënte këtë, sepse ne nuk kishim pronarët që kemi sot”, ka shtuar Guardiola. Pep Guardiola dhe Jurgen Klopp ka fituar katër titujt e fundit në Premier Ligë, tre spanjollit dhe një gjermani, kështu që është e kuptueshme që në rivalitetin mes tyre të ketë edhe tensione.

Lukaku, tifozëve të Interit: Ju dua, por më kuptoni

LONDËR, 15 GUSHT - Romelu Lukaku thyen heshtjen pas transferimit të tij nga Interi të Chelsea. Sulmuesi belg ka përhëndetur ish-tifozët e tij me një postim në rrjetet sociale: “Faleminderit që më keni dashur si të isha një nga ju. Kam vendosur të mos ju zhgënjë kurrë asnjëherë që kam veshur fanellën e Interit. Shpresoj ta kuptoni vendimin tim. Është mundësia e jetës për mua. Ju dua, mbetet gjithmonë interist”. Në mesazhin e tij sulmuesi ka ripërkthuar dy vjetët si interist: “Sezoni i parë është mbyllur në mënyrën më të vështirë të mundshme (humbja në finalen e Ligës së Evropës me autogol të vet belgut), por më keni dhënë forcën për të vazhduar: kjo është arsyeja pse jemi shpallur kampionë të Italisë”. 28-vjeçari ka shpjeguar më pas vendimin për t'u kthyer në Premier



Ligë. “Shpresoj ta kuptoni vendimin për të shkuar te Chelsea. Është mundësia e jetës për mua dhe

mendoj se në këtë çast të karrierës sime është rasti që kam ëndërruar gjithmonë”.

SHKURT

Ferit Keta, kampion bote në kikboks

Ferit Keta është kampion botë në kikboks në duelin e zhvilluar në kalanë e Bashkovës në Rrogozhinë. 32-vjeçari mposhti pa shumë probleme në tre raunde Gulliermo Bolkland brenda tre raundesh, nga pesë të mundshmet. 29-vjeçari nga Surinami, por me pasaportë holandeze, vuajti shumë duke rënë tri herë në ring, ndërkohë që në shumë raste të tjera rrëshqiste, duke ia bërë më të thjeshtë Feritit, i cili zhvilloi një ndeshje fantastike.

Ramos: Duam të fitojmë gjithçka

Një nga transferimet kryesore të PSG-së, Sergio Ramos, ka thënë se klubi nga kryeqyteti francez synon t'i fitojë të gjithë trofetë e mundshëm. “Një ditë e veçantë. Kemi një projekt të bukur për të fituar gjithçka. Ky është objektivi ynë. Shpresojmë t'u dhurojmë shumë trofe tifozëve tanë. Duam të luajmë një futboll të bukur dhe të fitojmë gjithçka. Parisi? Qytet magjik”, ka thënë Ramos. Ish-kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos Leo Messi, Gigio Donnarumma, Achraf Hakimi dhe Goergino Wijnaldum, janë transferimet e PSG-së.

Pogba verën tjetër shkon në Reali

Emri i Paul Pogbas është lidhur me PSG-në në periudhën e fundit. Mesfushori francez ka edhe një vit kontratë me Manchester Unitedit dhe po pret verën e ardhshme për t'u larguar si lojtar i lirë nga “Old Trafford”. “Sky Sport” shkruan se 28-vjeçari ka zgjedhur Real Madridin si ekipin e ardhshëm në karrierë. Pogba, i cili dhuroi katër asistime në fitoren 5-1 ndaj Leeds Unitedit në javën e parë të Premier Ligës, ka vendosur të respektojë deri në fund kontratën me Unitedin. Për shërbimet e kampionit të botës me “Gjelat” e Deschamps, interesohen PSG-ja, Juventus dhe Real Madridi, por lojtari e ka ndarë mendjen dhe sezonin 2022/2023 do të transferohet në “Santiago Bernabeu” nën urdhrat e Carlo Ancelottit.

Costa nëshkruan me Atletico Minieron

Ish-sulmuesi i Atletico Madridit, Diego Costa, ka nëshkruar për Atletico Mineiron, njoftoi vetë klubi brazilian. Costa kishte qenë pa klub që nga dhjetori pas largimit të tij nga Atletico Madridi, pasi kampionët e La Ligas u pajtuan për kërkesën e lojtarit për ta anuluar kontratën e tij. Në sezonin 2013-14, 32-vjeçari ndihmoi Atletico në titullin spanjoll me 27 gola dhe arriti në finalen e Ligës së Kampionëve, por humbi ndaj Real Madridit. Costa iu bashkua Chelseat në 2014, duke e dërguar klubin londinez në titujt e Premier Ligës 2014-15 dhe 2016-17, me 20 gola në secilën sezon.

Pochettino: Jam shumë i lumtur me Mbappen

Mauricio Pochettino, pas fitores 4-2 ndaj Strasburgut të shtunën, ka thënë se është shumë i lumtur me Kylian Mbappen. Sulmuesi francez u vërshëlye nga tifozët e Paris Saint-Germain. Mbappe, i cili është lidhur vazhdimisht me Real Madridin,

shënoi një gol tekta i sapoardhuri Lionel Messi e shikonte nga tribuna. “Unë nuk i dëgjova vërshëllimat. Jam shumë i lumtur me të. Ai është i fokusuar në atë që duhet të bëjë dhe pati një lojë vërtet të mirë. Ai duhet të vazhdojë në këtë rrugë”, ka thënë

Pochettino për “L'Equipe”. “Është shumë e rëndësishme për ne që të kemi përkrahësit tanë rreth nesh. Është e jashtëzakonshme dhe na ka munguar shumë. Futbollit është krejtësisht i ndryshëm me spektatorë. Me

prezantimin e të sapoardhurve ishte një mbrëmje e mrekullueshme për PSG-në. Tani ne duhet t'i përgatitim ata gradualisht, pa marrë shumë rreziqe, pavarësisht nëse është Leo Messi apo të tjerët”, ka shtuar Pochettino.



Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, nëntë (9) vende pune

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Prizren, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Pejë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Mitrovicë, katër (4) pozita
Prokuroria Themelore Gjakovë, dy (2) pozita

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ – 012
Emri pozitës: Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Kodi punës: DR/470
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave: Nëntë (9) pozita
Koeficienti: Nëntë (9)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna Provuose: Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë

Qëllimi i vendit të punës:

Bashkëpunëtori profesional, ofron mbështetje profesionale për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të prokurorit të shtetit, përmes hulumtimit, këshillimit dhe hartimit të akteve ligjore në fushëveprimtarinë e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon dhe arrinë pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e procedurave përkatëse, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
Kryen detyrat e parapara me plan të punës të miratuar në përputhje me ligjin, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
Bënë hulumtime ligjore, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandon për shqyrtim dokumentacionin me mbikëqyrësin e lëndës detyrën dhe aktet e specializuara për miratim, Mbështetë prokurorët në ushtrimin e funksionit të tyre;
Merr pjesë në cilësinë e ekspertit në seanca dëgjimore dhe në seanca gjyqësore kur kjo i kërkohet;
Kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë zyrtare lidhur me lëndët dhe informatat të cilat i bëhen të ditura gjatë punës;
Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës edhe me autoritetet e jashtme, gjithnjë duke u kujdesur për paraqitje të denjë të institucionit;
Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi Juridik;
Njohuri të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj).
Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, hartim të propozim akuzave, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësia për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.
Provimi i jurisprudencës.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune profesionale.

II. Zyrtar i Lartë Ligjor, një (1) pozitë

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Referenca: KPK/SKPK/POZ – 013
Emri pozitës: Zyrtar i Lartë Ligjor
Pozita: Pozitë e karrierës
Niveli: Profesional
Raporton tek: Drejtori të Sekretariatit
Numri i pozitave: Një (1) pozitë
Koeficienti: Nëntë (9)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna Provuose: Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve duke ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve normative dhe akteve të tjera juridike.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
Siguron përputhshmërinë e akteve nënligjore me legjisllacionin në fuqi në Kosovë;
Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ është e saktë e hartuar sipas teknikave standarde të shkrimit ligjor dhe identike në të tri gjuhët zyrtare;
Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim dhe zgjidhje;
Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të udhëheqësit të drejtpërdrejtë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt akteve të kërkuara për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit;
Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë organizative të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për realizim të aktiviteteve nga fusha e legjisllacionit;
Ndhmon në zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve të Këshillit, përmes dhënies së mendimeve profesionale dhe këshillave juridike;
Bën rekomandime profesionale dhe analiza ligjore me qëllim të nxerrjes dhe zbatimit të vendimeve të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
Njohuri të mira të procesit politikbërës dhe të planifikimit të përgjithshëm strategjik;
Aftësi të shkëlqyeshme në hartimin e dokumenteve strategjike, politikave, planeve, analizave, raporteve dhe dokumenteve tjera përkatëse;
Aftësi të mira organizative, aftësi pune në ekip, koordinimi, komunikimi, si dhe aftësi për të punuar nën presion;
Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës, shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power, Point Access);
Të ketë njohuri të gjuhës Angleze si dhe njohja e gjuhëve tjera të BE-së e mirëseardhur.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

Tri (3) vite përvojë pune profesionale.

III. Zyrtar Ligjor 2, dy (2) pozita

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 014
Emri pozitës: Zyrtar Ligjor 2
Pozita: Pozitë e karrierës
Kategoria funksionale: Profesional 2
Kodi punës: LI/060
Raporton tek: Administratori
Numri i pozitave: Dy (2) pozita
Koeficienti: Shtatë (7)
Akti i emërimit: Pa afat
Puna Provuose: Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi: Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve të Prokurorit duke i ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve, shkresave dhe daktilografimin e tyre si dhe mbajtjen e evidencave për lëndët në proces dhe të kryera nga Prokurori e në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Shkrimores së Prokurorisë dhe Udhëheqësin e Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ndhmon në mënyrë profesionale Prokurorin me daktilografim profesional të akteve që i nxjerr prokurori lidhur me lëndët konkrete të besuara për ndërmarrjen e veprimeve akuzuese nga prokurori;
Pranon lëndët e ndara për prokurorin me të cilin punon, evidentimin e tyre në mënyrë elektronike dërgimin e lëndëve me shkresat përcjellëse në shkrimore, mbajtjen e evidencës për lëndët në proces dhe lëndët e kryera, raporton për punën e vet te Udhëheqësi i Administratës;
Merr pjesë në procesin e dëgjimit të palëve duke e mbajtur procesverbalin e marrjes në pyetje, ruan konfidencialitetin e lëndës dhe palëve;
Kryen të gjitha punët përgatitore për praninë e palëve para prokurorit me dërgesën e ftesave dhe pranimin e konfirmimeve nga dorëzuesit e shkresave;
Gjithnjë kujdeset për informimin e Prokurorit lidhur me praninë e tij në gjykime, duke mos e lënë anash informimin lidhur me shkresat e ndryshme apo (corpora deliktet) që ndërlihen me lëndën gjyqësore;
Përgjegjës për kryerjen e punës në mënyrë sa më profesionale, duke u kujdesur që gjatë punës së besuar të ketë sa më pak lëshime;

Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të administratës, ndërsa për punën e kryer me prokurorin lidhur me lëndët mbanë edhe përgjegjësi tek prokurori i çështjes, andaj kërkohet një sy çelësi dhe vëmendje e veçantë;
I obliguar të respektojë Kodin e Etikës Profesionale të stafit mbështetës dhe Kodin e Shërbimit Civil;
Kryen edhe punë tjera që ndërlihen me pozitën e tij/saj duke i zëvendësuar kolegët tjerë në punë;

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi juridik dhe administratë publike;
Njohuri të mirë të gjuhës shqipe, dhe/ose serbe e dëshirueshme, në të shprehur me gojë dhe me shkrim duke përfshirë aftësi të zhvilluara në hartimin e dokumenteve;
Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj) dhe internetin;
Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I/E gatshëm/e të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

1 vit përvojë pune profesionale.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 16.08.2021 deri me datë 30.08.2021 si datë e mbylljes së konkursit.

- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
 - Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjisllacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 za Tužilački Savet Kosova, i na osnovu Zakona Br.03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova, na osnovu presude pod br. Ref ACJ. 1583/20 u predmetu br. KO203/19 Ustavnog suda od 9. jula 2020 godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova TSK/Br. 193/2021 datuma 26 mart 2021, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

KONKURS

I. Viši Službenik za Stručnu Saradnju, devet (9) pozicije

Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca, jedna (1) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Prizren, jedna (1) pozicija;
Osnovno Tužilaštvo Peć, jedna (1) pozicija;
Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, četiri (4) pozicije;
Osnovno Tužilaštvo Đakovica, dve (2) pozicije;

Referenca : KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ – 012
Naziv Pozicije: Viši Službenik za Stručnu Saradnju
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Radni kod: DR/470
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
Broj Pozicija: Devet (9) pozicije
Koeficijent: Devet (9)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Pristina, Prizren, Peć, Mitrovica, Đakovica

Cilj radnog mesta:

Unutar oblasti specifične stručne ekspertize, vršenje važnih stručnih dužnosti i pružanje usluga i proizvoda na nivou stručnjaka koje doprinose ispunjavanju ciljeva organizacione jedinice, bez bliskog nadzora na rad, ispituje i izrađuje potrebna pravna akta.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Razvije i dostiže saglasnost za radne planove i rokove, u koordinaciji sa nadzornikom, za sprovođenje dotičnih postupaka , usluga i proizvoda u specifično stručno polje;
Vrši predviđene dužnosti planom rada usvojenog u saglasnosti sa zakonom, pravilnicima, politikama i relevantnim procedurama, unutar vremenskih rokova;
Vrši istraživanje, analize, procenu opcija i preporučuje pretres dokumentacije sa nadzornikom predmeta, dužnost i specijalizovana akta za usvajanje;
Učestvuje u svojstvu stručnjaka na saslušanjima i sudskim ročištima kada mu se ovo zatraži;
Pobrinjava se za očuvanje službene tajne u vezi predmeta i informacija do kojih dolazi tokom rada;
Podržavaju tužioce u vršenju njihovih funkcija;
Koordinira rad sa ostalim jedinicama institucije i komunicira po potrebi i sa spoljnim autoritetima, uvek brineći se za dostojanstveno predstavljanje institucije;
Vrši svaku drugu dužnost u specifičnu stručnu oblast u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koja se povremeno može zatražiti na razuman način.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Sveobuhvatna odlična stručna poznavanja iz oblasti prava;
Dobra poznavanja rada na računaru sa primenom programa (Microsoft Word, Excel, Power Point, i dr).
Sposobnosti za razmatranje predmeta, izradu predlog optužnica, optužnica i ostalih potrebnih spisa;
Spreman da radi za ljudima raznih nacija i religija;
Sposobnosti za preduzimanje konkretnih inicijativa tokom rada i u vezi istog;
Sposobnosti održanja kvaliteta rada u uslovima rada pod tenzijom.

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet .
Pravosudni ispit.

Radno Iskustvo:

Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva.

II. Viši Pravni Službenik, jedna (1) pozicija

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova

Referenca : KPK/SKPK/POZ – 013
Naziv Pozicije: Viši pravni službenik
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Raportira kod: Direktor Sekretarijata
Broj Pozicija: Jedna (1) pozicija
Koeficijent: Devet (9)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Pristina,

Cilj radnog mesta:

Preduzima sve konkretne radnje i profesionalne inicijative za obavljanje što efikasnijeg i kvalitetnijeg posla pružajući stručnu pravnu podršku u izradi normativnih akata i drugih pravnih akata.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Priprema normativne akte, kao i druge pravne akte koji proizilaze iz oblasti delovanja Saveta i Državnog Tužioca;
Osigurava usklađenost podzakonskih akata sa važećim zakonodavstvom na Kosovu;
Stara se o tome da su sadržaj i oblik normativnog akta pravilno sastavljeni prema standardnim pravnim i identičnim tehnikama pisanja na sva tri službena jezika;
Sprovodi istraživanje i analizu informacija o temama koje je odredio supervizor i identifikuje opcije ili pitanja za razmatranje i rešavanje;
Prema zahtevu i uputstvima direktnog rukovodioca, daje pravna mišljenja i izrađuje potrebne akte za Savet i Državnog Tužioca;
Sarađuje i komunicira sa organizacionim jedinicama Saveta i Državnog Tužioca radi izvršenja aktivnosti u oblasti zakonodavstva;
Pomaže u sprovođenju odluka i propisa Saveta, putem davanja stručnih mišljenja i pravnih saveta;
Daje stručne preporuke i pravnu analizu u cilju donošenja i sprovođenja odluka Saveta i Državnog Tužioca;
Obavlja i druge poslove u skladu sa svrhom posla a koje može zahtevati nadzornik.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Dubinsko i specijalizovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, stečeno univerzitetskim obrazovanjem i odgovarajućom obukom;
Dobro poznavanje procesa kreiranja politike i opšteg strateškog planiranja;
Odlične veštine u izradi strateških dokumenata, politika, planova, analiza, izveštaja i drugih relevantnih dokumenata;
Dobre organizacione sposobnosti, sposobnost rada u timu, koordinacija, komunikacija kao i sposobnost rada pod pritiskom;
Veštine u komunikaciji, planiranju rada, istraživačke, analitičke, procenjivačke sposobnosti kao i prilikom formulisanja profesionalnih preporuka i saveta;
Računarske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power, Point Access);
Poželjno je da poznaje Engleski jezik kao i druge jezike EU-a.

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet.

Radno Iskustvo:

Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva.

III. Pravni Službenik 2, dve (2) pozicije

Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca

Preporuka: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ – 014
Naziv Pozicije: Pravni Službenik 2
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni 2
Poslovni Kod: LI/060
Raportira kod: Administrator
Broj Pozicija: Dve (2) pozicije
Koeficijenti: Sedam (7)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Pristina

Cilj radnog mesta:

Preduzima sve konkretne radnje i profesionalne inicijative za obavljanje efektivnijeg i kvalitetnijeg poslova Tužilaca, pružajući pravnu stručnu podršku uz izradu akata, spisa i njihovom daktilografiranju, kao i vodi evidencije o predmetu koji su u prostupku i koji su završeni od strane tužioca u saradnji sa Nadzornikom Pisarnice Tužilaštva i Rukovodiocem Administracije.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Pomaže na profesionalan način Tužiocu uz profesionalno daktilografiranje akata koje iznese tužilac u vezi konkretnih poverenih predmeta za preduzimanje optužnih radnji od strane tužilaca;
Prima predmete koji su dodeljeni za tužioca sa kojim radi, njihovo elektronsko evidentiranje, dostavljanje predmeta uz pratećih spisa u pisarnici, vođenje evidencije za predmete koji su postupku i o završenim predmetima, izveštava o svom radu Rukovodioca Administracije/ Administratora;
Učestvuje u procesu saslušanja stranaka vodeći zapisnik ispitivanja, sačuva konfidencijalnost predmeta i stranaka;
Obavlja sve pripremne poslove za prisustvo stranaka pred tužiocem uz slanjem pozivnice i primanjem potvrde od dostavljača dopisa;
Uvek se pobrine za informisanje Tužioca u vezi njegovog prisustva na suđenja, ne zanemarujući informisanje u vezi različitih spisa ili (corpora delikti) koji se nadovezuju sa predmetom;
Odgovoran za obavljanje poslova na stručan način, pobrineći se da tokom posla koji mu je poveren ima što manje propusta;

svom radu odgovara Rukovodiocu Administracije, a za obavljeni rad sa tužiocem u vezi sa predmetima vodi odgovornost i kod tužioca predmeta, stoga se zahteva posebna pažnja i trezvenost;
Obavezan da poštuje Kod Profesionalne Etike pomoćnog osoblja i kod o civilnoj službi;
Obavlja i ostale poslove koje su vezane sa njegovom pozicijom, zamenjući ostale kolege na poslu.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlična sveobuhvatna stručna znanja iz Javne Upravne Pravne oblasti;
Dobro poznavanje albanskog, i/ ili srpskog je poželjno, u pismenom i usmenom izražavanju, uključujući razvijene sposobnosti u izradi dokumenata
Znanja sa dobrim kompjuterskim radnim sposobnostima uz aplikacije programa (Microsoft Word, Excel);
Sposobnost za preduzimanje konkretnih inicijativa tokom rada i vezano sa tim;
Sposobnost da zadrži kvalitet rada i pod uslovima rada pod pritiskom.

Stručna Sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska diploma Pravni Fakultet.

Radno Iskustvo:

Najmanje 1 godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 16.08.2021 do 30.08.2021 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Prishtina, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Prishtina.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učesća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
 - „Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova“.
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

gluten
free

MEKA
HALAL FOOD

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues